

Momente krize

Gil Caroz

Një hipotezë: lista e grupeve psikanalitike që formojnë NLS-në përmbajnë një dije rreth “krizës”, që do të përbënte interes nëse do të nxirrej në dritë. Nëse e konsiderojmë krizën si një prej shënjesve kyç (kryeshënjesit) të kohës sonë dhe që si e tillë përbën një mënyrë për ta emërtuar realen, panoplia e vendeve që mbulon shkolla jonë mund të na mësojë mbi një seri mënyrash në marrëdhënie me realen. Midis Izraelit, vend vazhdimisht në krizë dhe Zvicrës që duket se i shmang të gjitha krizat, Greqia dhe Irlanda u bënë shenjat e krizës ekonomike në Europë, Britania e Madhe dhe Kanadaja janë prekursorët e krizës së shkencizmit dhe teknologjisë, Belgjika është vendi i një krize gjuhësore, Ukraina është e përshënjuar nga krizat e një shteti që e ka të vështirë të imponohet si i tillë e kështu me rradhë

Shënjesi “krizë” i referohet, etimologjikisht, një momenti kritik trazirash si dhe një gjykimi ndaj marrjes së një vendimi. Ky shënjes u përvetësua nga mjekësia që prej kohës së Hipokratit për të përshkruar një fazë të sëmundjes ku simptomat shfaqen me forcë të madhe. Me kohën termi “kriza” e gjeti vendin shumë natyrshëm te fusha e psikiatrisë dhe depërtoi me lehtësi në dimensionet e Tjetrit të cilin ne e quajmë politik, shoqëror, ekonomik, historik dhe moral. Sot ky shënjes është pjesë e gjuhës së përbashkët.

Kriza dhe koha

Kriza ka një marrëdhënie me kohën. Hannah Arendt flet për krizën si një pikë takimi konfliktuale ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes¹. Kjo pikë nuk është e tashmja. Kjo duhet kuptuar më tepër si një çarje në kohë e cila duket kur tradita që deri në atë moment i ofronte kornizën reales zhduket dhe koordinatat e reja simbolike të së ardhmes nuk njihen akoma. Subjektit atëherë i duhet ta luajë lojën e tij përkundrajt reales, që zhytet në brendësi të këtij boshllëku të krijuar në intervalin midis dy sistemeve simbolike.

Por kriza nuk është një koncept psikanalitik. Ndaj na duhet të kufizohemi në përdorimin që ia bëjmë, ndërkohë që i japim vetes lirinë për të shtënë në dorë të gjitha format me të cilat shënjesi shfaqet në kulturë. Pikën tonë të parë mbështetëse do ta gjejmë në një përkufizim të Jacques-Alain Miller gjatë një interviste të dhënë për revistën *Marianne* mbi krizën ekonomike. “Ka krizë në kuptimin psikanalitik kur ligjërimi, fjalët, figurat, rritualet, rutina, i gjithë aparati simbolik gjendet papritmas i pafuqishëm për të zbutur realen që vepron vetëm në kokë të saj. Kriza nuk është gjë tjetër veçse realja e shfrenuar, e pamundur për tu kontrolluar. Në qytetërim, ekuivalentet e saj janë stuhitë që vijnë kohë pas kohe për t’i kujtuar qenies njerëzore mungesën e sigurisë dhe dobësinë e saj thelbësore”². Në të njëjtën frymë, në “Hyrje në erotikën e kohës” ,

¹ Hannah Arendt, *La crise de la culture*, Gallimard, 1972.

² La crise financière vue par Jacques-Alain Miller, *Marianne*, 10 octobre 2008.
<http://www.departementpsychoanalyse.com/documents.aspx?Page=2>

Jacques-Alain Miller citon propozimin e Deleuze sipas të cilit “koha e vë në krizë të vërtetën”³. E thënë ndryshe, e vërteta nuk është e përjetshme, ajo shuhet me kohën. Në këtë pikë ajo dallon nga realja që nuk njih ligje dhe nuk i bindet asgjëje, as vetë kohës. Që koha e vë në krizë të vërtetën, nënkupton se kjo e fundit lëkundet në një moment të caktuar kur mbërthehet nga një reale të cilën nuk mund as ta trajtojë, as ta kontrollojë. Prandaj kriza shfaqet si një moment shkëputje nga vija e kohës, një ngjarje që e nxjerr subjektin nga rutina e tij dhe e detyron të përpunojë një marrëdhënie me realen. Kjo marrëdhënie e krizës me kohën na bën të flasim për “*momente krize*”.

Hiper-kriza

Kriza që shfaqet në këtë trajtë, si prerje në rrjedhën e kohës, i përket kohës së Edipit. Pas Edipit, ky model i thjeshtë dialektik ndërmjet rutinës dhe ngjarjes që përbën krizë nuk na mjafton më për ta lexuar fenomenin. Kjo është arsyeja pse sociologët e kanë braktisur emërtimin “post-modernizëm” për t’i lënë vendin hipermodernitetit⁴. Në fakt, postmodernizmi kushtëzohet në përshkrimin e diziluzioneve të fillimit lidhur me progresin dhe humanizmin e Iluministëve që pasuan Luftën e Dytë Botërore. Por për të përshkruar ndryshimet cilësore të njeriut përgjatë tre dekadave të fundit, ishte e nevojshme që fjalës “modernizëm” t’i shtohej parashtesa “hiper”. Kjo e përcjell më mirë nocionin e teprisë, përkeqësimit dhe garës përndjekëse pa kurrëfarë mase që karakterizon ngjitjen në zenit të objektit *a* si pasojë e ligjërimit kapitalist.

Çfarë do të thotë kjo? Precipitimi i ngjarjeve nuk kufizohet në një përshpejtim të thjeshtë në rrjedhën e kohës. Teknologjitë e fundit prodhojnë një lloj tkurje të kohës dhe hapësirës. Me anë të mjeteve të thjeshta si *Skype* apo *Facebook* distancat shfuqizohen dhe kohëzgjatja reduktohet në menjëherëshmëri. Sapo një ngjarje shfaqet, po menjëherë një tjetër fillon të nisë. Modeli *rutinë-krizë-rutinë* u zëvendësua nga seria *krizë-krizë-krizë* që vazhdon në infinit. Kalimi nga momenti i vështrimit dhe momenti përfundimtar është shpesh i menjëhershëm dhe e qarkrrethon kohën për të kuptuar.

Në këto kushte bota nuk ndjek më tezën e Hannah Arendt. Nuk bëhet më fjalë për një konflikt ndërmjet të shkuarës dhe së ardhmes presioneve të së cilës i nënshtrohet subjekti. Linja e kohës mbërthehet vazhdimisht nga realja në një seri momentesh krize, pa pritur asnjë çast. Sapo një sistem simbolik vendoset, ai luhatet për t’i lënë vendin një tjetri. Pranvera arabe na duket tanimë si një histori e vjetër. Por nuk ka veçse pak më shumë se tre vjet. Kjo kryengritje u përhap në një seri vendesh me shpejtësinë e një zjarri, falë mbështetjes së rrjetit social. Në pak kohë, ne i pamë tiranët të binin nga froni i tyre dhe të gjykoheshin, dënoheshin me ose pa gjykim, ndërkohë që të gjitha këto u mediatizuan në kohë reale kudo në botë. Që prej asaj kohe në këto vende nuk kemi parë ende të vendoset rendi i ri. Krizat vazhdojnë të ndjekin njëra tjetrën.

³ Jacques-Alain Miller, « Introduction à l'érotique du temps », *La Cause freudienne*, n°56

⁴ Nicole Aubert, *L'individu hypermoderne*, Toulouse, Eres, 2010

*Kriza teknike*⁵

Në fushën që na intereson, të ashtuquajtur të “shëndetit mendor”, konstatojmë se përgjigjet e dhëna gjatë shfaqjes së krizave në kulturë po dalin jashtë binarëve. Në një artikull të titulluar “Kriza postmoderne dhe psikanaliza⁶” Eric Laurent rishqyrton konceptin e Foucault-së mbi biopolitikën për të përshkruar lëvizjen që shfuqizon klinikën për ta zëvendësuar me menaxhimin mjekësor të popullsisë. Kjo lëvizje “ vjen të zëvendësojë të drejtën e Shteteve për “t’i dhënë fund jetës” e cila më parë bëri të mundur menaxhimin e identifikimeve”. Në 2011, këshilli rajonal i O.B.SH-së për shëndetin mendor na e konfirmoi me një mesazh që i adresohet pjesëmarrësve të kongresit të parë të psikanalizës, PIPOL 56⁷.

Sot, ne e shohim me keqardhje kohën kur kjo ëndërr e shtetit mbi mbikqyrjen shoqërore mbështetet në një dije mjekësore. Në shekullin e XX-të, teknika zuri vendin e dijes. *Çekiçi pa mjeshterin*, ky është skenari i ëndjes⁸ (fr. *jouissance*). Teknika nuk synon gjë tjetër veçse të vihet në veprim si teknikë. Ajo nuk është një praktikë në shërbim të mjeshtrit dhe idealit të tij, por një ëndje mjeshtri i së cilës shndërrohet në instrument, me dijeninë apo padijeninë e tij. Jean-Claude Milner e shtyn këtë deri në ekstrem. Sipas tij, dhomat e gazit nuk ishin mjetet që u vunë në përdorim nga ideologjia naziste. Ideologjia naziste për teknikën ishte më tepër rasti për t’u shfaqur nëpërmjet dhomave të gazit⁹.

Duke patur në mendje ndryshimet midis tyre por duke përjashtuar mizorinë e këtyre të fundit, shohim gjithashtu se edhe DSM-ja është një manifestim i teknikës. Që në botimin e tretë të saj, kur spastroi çfarëdo reference ndaj psikanalizës, DSM-ja tashmë paraqitet si *ateorike* apo thënë ndryshe si e pavarur nga teoria. Madje e deklaroi këtë me krenarinë e një çekiçi pa kokë. Klasifikimi i saj bazohet më tepër mbi një matje statistike të objektit sesa tek dija. Pretendon se është objekti që flet. Por përkundrazi, objekti nuk flet¹⁰.

Çrregullimet e shënuara në DSM, si pjesë e kësaj praktike të shifrës, nuk hyjnë në marrëdhënie me realen. Këto janë shenja rreth të cilave organizohen masat trupore njerëzore. Ato lejojnë standartizimin e diagnozave klinike në të gjithë botën, duke hapur kështu tregje të reja për barnat psikotrope. Për më tepër, ndarja nga njëra anë e kategorive nozografike dhe nga ana tjetër e klinikës, lehtëson rritjen e numrit të çrregullimeve që i shtohen çdo versioni të ri të DSM-së si dhe zgjerimin e kufijve të çdo çrregullimi. Kështu me qëllim që të gjej aplikimin e saj kudo, shkenca e aplikuar [*teknika*] lëviz pa kontroll, duke klasifikuar dhe mjekuar në një mënyrë maniake, pa e

⁵ [Termi në frëngjisht, *teknikë*, mund të përkthehet dhe si “shkencë e aplikuar”]

⁶ Eric Laurent, “La crise post-DSM et la psychanalyse”, [http://www.latigolaciano.com/assets/2\)-ltgzo-3-francés-la-crise-post.pdf](http://www.latigolaciano.com/assets/2)-ltgzo-3-francés-la-crise-post.pdf)

⁷ Matt Muijen, “Message du Conseiller régional de l’OMS pour la Santé mentale – Région Europe”, Mental, Revue internationale de Psychoanalyse, n° 27/28, septembre 2012. [Mesazh nga Këshilltari Rajonal i O.B.SH-së për shëndetin mendor, Rajoni i Europës.]

⁸ Termi ‘ëndje’ do të përdoret në vazhdim si një përkthim i përkohshëm i termit francez ‘jouissance’.

⁹ Jean-Claude Milner, *Le juif du savoir*, Paris, Grasset et Fasquelle, 2006

¹⁰ Jean-Claude Milner, *La politique des choses*, Navarin, Paris, 2005.

hedhur spirancën tek realja. APA, Shoqata Amerikane e Psikiatrisë, që publikon DSM-në është thjesht instrumenti që i lejon shkencës së aplikuar të rrëmbehet e shpënguar.

Një klinikë e krizës

Parehatia në qytetërim¹¹, siç kemi thënë, na tregon se krizat pasojnë njëra tjetrën. Cilat janë pasojat për subjektin e këtyre krizave pambarim si fenomene të qytetërimit ?

Qytetari perëndimor ekspozohet vazhdimisht ndaj informacioneve katastrofike që vijnë nga çdo cep i planetit, si dhe që provokohen nga objekte tepër joshëse që ngacmojnë pulsionet e tij *perverse polimorfe*. Sirenat e pornografisë janë të parat në listë në këtë aspekt. Ankthet dhe tepritë e konsumimit përzihen. Filmi *Shame*, i Steve McQueen-it e ka përshkruar në mënyrë të shkëlqyer këtë galop të furishëm të *ëndjes*, pasojë e dështimit të simbolikes dhe reduktimit të njeriut në mjerimin e trupit të tij.

Ky *jogg-ing* i vazhdueshëm i subjektit, nga kriza në krizë, nga e papritura në të papritur, e shndërron atë në një mi laborator, më tepër një objekt të zhytur në një reale sesa një subjekt, në një garë të shfrenuar ndërmjet shokut elektrik dhe shpërblimit. Atje ku dikur ligjërimi i mjeshtrit urdhëronte “ec ose vdis”, ligjërimi kapitalist është më kërkues dhe imponon një “vrapo ose vdis”. Prapa këtij ligjërimi përshpejtues të pafund struket brishtësia e lidhjes sociale dhe flakja si mbeturinë e të gjithë atyre që me stërmundime përpiqen të mbajnë këtë ritëm të tmerrshëm. Kështu përtej strukturave psikike, kjo dyfaqësi e subjektit që nxiton dhe e atij që “vdes” vjen si jehonë e binarit klinik të mani-melankolisë. Mania e përkufizuar si një ikje përpara që shpaguhet në trajtën e një furie shënjesish të shkarkuar nga objekti. Melankolia, për subjektet të cilët nuk mundën më ta ndjekin këtë garë, braktisin gjithshka dhe mishërojnë objektin e rënë prej Tjetrit.

Një kërkim na imponohet në nivelin e strukturave klinike. Këtu do t'i kufizoj sugjerimet.

Për psikozën do të ishte padyshim interesante të shqyrtohej çështja e krizës nisur nga treshja *shpërfaqje, dekomensim* dhe *shkëputje*. Të treja janë trajta krizash nëse marrim parasysh se bëhet fjalë për një lëkundje të simbolikes, një shfaqje të reales dhe më pas vendosja e një forme të re të simbolikes. Por padyshim ka vend për të bërë dallime midis një *shpërfaqje* si rrjedhojë e takimit me *Një baba*, një shpërfaqje fill pas shpërbërjes së regjistrit imagjinar, një shpërfaqje si rikthim i një shpërfaqje që ka ndodhur më herët dhe shkëputja që vjen prej braktisjes së subjektit nga Tjetri.

Tek neuroza, simbolikja nuk është kurrë tërësisht e rrënuar. Grisja e velit të fantazmatikës është një moment krize që mund ta çojë subjektin drejt analizës. Subjekti nuk përfton më kënaqësi prej *ëndjes* së tij dhe i ekspozohet angështisë si rrjedhojë e dyndjes së dëshirës së Tjetrit. Por më pas, është vetë psikanalisti që e mbart këtë rol dhe shndërrohet në krizë për neurotikun. Në të gjitha udhëkryqet sidomos ato që trondisin apo zbërthejnë mbrojtjen, ka vend për t'u shfaqur kriza e shoqëruar me angështi. Muaji i mjaltit në fillim të analizës zëvendësohet shpejt nga një

¹¹ Titulli i një vepre të papërkthyer në shqip të Sigmund Freud-it, “Das Unbehagen in der Kultur”, 1929.

ndreqje subjektive që bën psikanalisti. Rënia e pozicionit falik dhe e idealeve pasohet nga një përkeqësim i simptomave. Skamja subjektive nuk është tamam një moment dëfrimi, të paktën jo që në fillim. Rënia e subjektivit-të-hamendësuar-me-dije dhe kapërcimi i fantazmatikës mund të përjetohet edhe si krizë.

Le të ndalemi pak në veçanti në atë ç'ka përbën krizë tek perversioni. Patëm rastin të përjetonim një mini-krizë gjatë zbulimit të imazhit të austriakut Tom Neuwirth, të ashtuquajtur *Conchita Wurst*, i cili fitoi çmimin e parë në Eurovizion 2014. Gjashtëmbëdhjetë vite kanë kaluar që kur këtë çmim e mori transeksuali izraelit *Dana International* por duket se një botë e tërë i ndan këta fitues. Ndërkohë që imazhi i *Dana International* hyn lehtësisht në kategorinë e grave, imagjinata jonë nuk ka akoma një vend ku mund të hyjë imazhi i një burri me një mjekër si ajo e *Conchitës*. Realja e ëndjeve singolare të saja që bartin kërkesën për identifikim dhe mirënjohje na mbërthejnë vazhdimisht duke na vënë në krizë.

Conchita nuk e fsheh kënaqësinë që ai ose ajo merr nga kjo lëkundje e prodhuar tek Tjetri. Show-t e tij, fjalët dhe komentet e këngëve të tij, që njëkohësisht provokojnë dhe sfidojnë çmimin e parë që fitoi, janë një konfirmim i mënyrës së tij të ëndjes por edhe mjete për të sfiduar normat konformiste. Në Austri, opinionet u ndanë ndërmjet personave, sidomos të ekstremit të djathtë, që u fyen nga fakti që ky lloj imazhi mund të përfaqësonte vendin e tyre dhe nga ana tjetër të rinjve plot me gjallëri të cilët thurën mjekra artificiale në shenjë mbështetjeje dhe identifikimi me *Conchita-n*. Disa politikanë rusë nuk humbën kohë të dënonin dekadencën europiane. Padyshim kjo ishte dhe një kunjë që i hidhej ukrainasve besnikë të Kievit: *doni të jeni europianë e pra shikojeni se ç'është Europa nën imazhin e Conchita Wurst*. Konstatojmë se nëse tek psikoza dhe neuroza kriza është nga ana e subjektivit, tek perversioni është Tjetri ai që është në krizë.

Psikanaliza nuk i gjykon këto çështje. *Conchita* do të ishte i mirëpritur në zyrën e psikanalistit. Por jashtë zyrës, konflikti ka gjasa të rritet midis palëve ku nga njëra anë qëndrojnë forcat represive që nuk dëshirojnë ndryshime dhe nga ana tjetër e rivendikimeve për identifikime të reja sa i përket mënyrave të reja të ëndjes. Kjo është e pashmangshme. U mësuam shpejt me *Dana International*. Sot ajo është pjesë e imagjinare sonë. Edhe *Conchita* do të bëhet pjesë e saj. Pasi ashtu siç thotë Jacques-Alain Miller ndërsa një pjesë e botës po *feminizohet*, ajo do të bëhet gjithnjë e më tolerante kundrejt këtyre zgjidhjeve të cilat në fillim paraqiten si simptomatike për disa subjekte në një moment të dytë bëhen mënyra të përhapura.

Kështu perversioni vë në krizë rutinën tonë konformiste dhe e çon përpara botën përgjatë rrugës së dëshirës drejt arritjeve të reja edhe kur nuk e konsiderojmë performancën e *Conchita-s* si një sublimim të suksesshëm në aspektin kulturor. Ky konflikt midis konformizmit kulturor dhe perversionit nënvizohet nga Lacan-i në fund të *Seminarit VI* kur ai nyjton perversionin me sublimimin : “ne mund të shtrojmë çështjen se çfarë prodhohet në trajtë perversioni pasqyron, në nivelin e subjektivit logjik, një protestë kundrejt së cilës subjekti nënshtrohet në nivelin e

identifikimit (...) Nga njëra anë pajtimin dhe nga ana tjetër, perversionin, në atë masë që përfaqëson, në nivelin e subjektit logjik, protestën që ngrihet në regjistrin e dëshirës”.¹²

Si rrjedhim, krijohet një përmbysje. Aty ku deri tanimë leximi ynë i krizës mund të kuptohej si një profeci e tmerrshme sipas stilit të testamentit të vjetër, me perversionin në e gjejmë tashmë krizën në një version miqësor kundrejt psikanalizës. Nëse kriza është me raste burim lotësh dhe dhimbjesh, ajo është gjithashtu një kalim i detyruar drejt shpikjes dhe së resë. Ky është një përkthim i mundshëm i asaj që thotë Jacques-Alain Miller në intervistën e revistës *Marianne* të lartpërmendur. “Psikanalisti është mik i krizës”.

Urgjenca dhe akti

Miqësia ndërmjet psikanalizës dhe krizës nuk është një simpati e thjeshtë për pasojat e krizës të përfuara gjatë sfidës që kërkon të trondisë konformitetin e normave. Kështu Lacan-i, në *Analyticon*-in e tij tek *Seminari VII* këshillon të mos i zëmë besë ëndjes së kontestatorit të cilën ai e krahason me atë të beqarit. “Bëni kujdes se mos kontestatori bëhet vetë çokollatë”¹³. Afërsia midis psikanalizës dhe krizës ka themele të forta që kalojnë nëpërmjet dimensionit të urgjencës dhe të aktit, të dyja këto janë kushte të domosdoshme për të mundësuar krijimin, në mënyrë që të ketë modifikim të pozicionit të subjekti dhe që gjërat të mos jenë më siç kanë qenë më parë.

Fakti që u nisëm nga krizat e botës politike nuk duhet të na mashtrojë. Kriza, si mike e psikanalizës po aq sa urgjenca e aktit të cilin ajo e vë në lëvizje nuk duhet të lexohen me syzet e ligjëratës së mjeshtrit. Psikanalisti nuk është punonjës urgjencash apo zjarrfikësesh. Sigurisht që ai duhet të njohë situatat që e tejkalojnë fuqinë e fjalës në mënyrë që ta orientojë subjektin kur lind nevoja drejt diskurseve të tjera, si mjekësia: krizat e panikut që nuk zbuten, rreziqe vetëvrasjeje të një subjekti që ka bindjen e pamposhtur e pavleshmërsie së tij, një mbingarkesë deluzioni me prirje për kalime në akt pa asnjë mbështetje tek Tjetri, haluçinacione invazive etj...

Ndërsa këto ngjarje gjatë kurës kërkojnë një *veprim* nga psikanalisti, koordinatat e urgjencës të cilave u përgjigjet me anë të *aktit* të tij, janë të një lloji tjetër. Këtu ka vend të dallohet veprimi që i përket regjistrin të së mundshmes dhe akti që përftohet në një sfond pamundshmërie¹⁴.

Lacan-i i cilësoi urgjencat në psikanalizë si *subjektive*¹⁵. Këto shfaqen kur subjekti ndeshet me traumën e gjuhës për aq sa ajo e refuzon kuptimin. Urgjenca në fjalë është nga ana e subjektit dhe është një urgjencë për të thënë në mënyrë që të tejkalohet në vërtetësinë e saj¹⁶. Kjo formulë nuk është vetëm e volitshme për të përshkruar hyrjen në analizë. Ajo i korespondon gjithashtu të

¹² Jacques Lacan, Le Séminaire livre VI, *Le désir et son interprétation*, Editions de la Martinière, Le Champ freudien, 2013, pp. 569-570.

¹³ Jacques Lacan, Le Séminaire livre XVII, L'envers de la psychanalyse, Paris, Seuil, 1991, p. 229.

¹⁴ [Fr.] Jacques-Alain Miller, « Introduction à l'érotique du temps », p. 81.

[En.] Jacques-Alain Miller, “Introduction to the Erotics of Time”, *Lacanian Ink*, 24, 2005

¹⁵ Jacques Lacan, “Of the Subject finally in Question”, *Écrits*, trans. Bruce Fink, London, Norton, 2006, p. 196.

¹⁶ Jacques Lacan, “Function and the field of speech and language in psychoanalysis”, *Écrits, op. cit.*, p.201: “Nothing created appears without urgency; nothing in urgency fails to surpass itself in speech”.

gjitha momenteve të krizave që kanë ndodhur tashmë gjatë kurës. *Subjekti-i-hamendësuar-me dije* e shtyn të analizuarin t'i shpalosë shënjesit që burojnë nga pavetëdija si shumë të vërteta. Këtë e quajmë të pavetëdijshmen transferenciale. Por kjo e fundit në disa momente udhëkryqesh mbërthehet nga e pavetëdijshmja reale¹⁷, një shënjes tërësisht fillikat “i cili nuk bart më kurrëfarë kuptimi (apo interpretimi)”¹⁸, që nuk lidhet me asnjë shënjes tjetër duke i rezistuar kështu prodhimit të një të vërtete.

Këto momente ndiqen në një farë mënyre nga një lëkundje në procesin e kurës. Këtu akti thirret në vendin ku asnjë S2 nuk mund të përgjigjet për ta mbuluar dyndjen e reales me një kuptim. Në këto momente psikanalisti duhet të luajë pjesën e tij në mënyrë që depërtimi i kufijve autikë të shënjesit fillikat qëndron në brendësi të kurës në trajtën e një *mirëthënieje* që zë vend. Në të kundërt do të jetë subjekti ai që do të marrë përsipër aktin qoftë me një *acting out* që do të ngelet i nyjetuar me fjalën, ose me anë të një kalimi në akt që e ndan nga Tjetri përkundrejt çmimit të daljes nga skena ose të një *shpërfaqjeje* psikotike.

Këto momente të brishta paraqiten shpesh si kriza transferenciale. Kjo mund të variojë nga një agjitim jashtë seancës në një mënyrë që është kundërproduktive për kurën deri në shkëputjen përfundimtare me psikanalizën, duke kaluar përmes manifestimit të një transference negative pak a shumë të fortë, por edhe tek shkëputja me vetë psikanalistin për ta vazhduar analizën gjetiu etj. Por kur kura vazhdon, këto momente mund të paraqiten si mjaft pjellore duke patur në horizont fundin e kurës nëse akti përfundon me një kalim nga pozicioni i të analizuarit tek ai i analistit.

E kuptuat. Për Kongresin e NLS-së për 2015 i propozova presidentin tonë të ri Yves Vanderveken titullin e mëposhtëm: “Momente krize”. U përpoqa të hapë disa dyer të cilat mund të na vënë në punë mbi këtë temë. Shpresoj t’ia kem arritur qëllimit që t’ju zgjojë interesin.

¹⁷ Jacques-Alain Miller, « L’inconscient réel », *Quarto*, n° 88-89, décembre 2006.

¹⁸ Jacques Lacan, “Preface to the English Language Edition [of Seminar XI]”, *The Four Fundamental Concepts of Psychoanalysis*, trans. Alan Sheridan, p. vii.